



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERËT PUBLIKË**

Nr. \_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 26.1.2024

**Lënda:** Lidhur me denoncimet për subjektin e rivlerësimit, z. Juljan Çafka, të depozituara pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, pas depozitimit të ankimit

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Për subjektin e rivlerësimit z. Juljan Çafka, pas depozitimit të ankimit në datë 11.11.2021, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, janë përcjellë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, konkretisht, këto denoncime dhe ankesa të publikut:

**1.** *Denoncim i shtetases* \*\*\* \*\*\*, drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, përcjellë nga KPA-ja me shkresën nr. \*\*\*/\*\* prot., datë \*\*.7.2023, dhe regjistruar në IKP me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.7.2023; Denoncuesja i është drejtuar KPA-së lidhur me procedimin penal nr.\*\*\*, datë \*\*.3.2019, të hetuar nga subjekti i rivlerësimit dhe pretendon se ky prokuror e ka pushuar katër herë dhe katër herë vendimi është rrëzuar nga gjyqtari paraprak, duke cituar datat e vendimeve dhe gjyqtarët<sup>1</sup> që kanë shqyrtuar çështjen, dhe i ka bashkëlidhur denoncimit vetëm dy fotokopje të “Kontratë shitje” nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.2.2005, e pretenduar si akti objekt procedimi. Sa më lart, konstatohet nevoja e hetimit të mëtejshëm në drejtim të verifikimit nëse është subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Çafka, prokurori i çështjes të procedimit penal nr. \*\*\*, datë \*\*.3.2019, dhe veprimeve procedurale të kryera.

**2.** *Denoncim i shtetasit* \*\*\* \*\*\*, drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, përcjellë nga KPA-ja me shkresën nr. \*\*/\* prot., datë \*\*.1.2024, dhe regjistruar në IKP me nr. \*\*/\* prot., datë \*\*.1.2024; Denoncuesi i është drejtuar KPA-së lidhur me procedimin penal me nr. \*\*\*/2017, të hetuar nga subjekti i rivlerësimit, ku të pandehur janë shtetasit \*\*\* dhe \*\*\* \*\*\* (djemtë e denoncuesit), të akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal. Ky denoncim është trajtuar edhe gjatë hetimit administrativ në Komision dhe nuk është pjesë e ankimit të Komisionerit Publik.

<sup>1</sup> Vendimi datë \*\*.1.2021, nga gjyqtarja \*\*\* \*\*\*; Vendimi datë \*\*.1.2022 nga gjyqtarja \*\*\* \*\*\*; Vendimi datë \*\*.5.2022, nga gjyqtari i Apelit \*\*\* \*\*\*; Vendimi datë \*\*.5.2023, gjyqtari \*\*\* \*\*\*.

3. *Denoncim i shtetases* \*\*\* \*\*\*, drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, përcjellë nga KPA-ja me shkresën nr. \*\*/\*\* prot., datë \*\*.1.2024, dhe regjistruar në IKP me nr. \*\*/\* prot., datë \*\*.1.2024. Denoncuesja i është drejtuar KPA-së lidhur me procedimin penal me nr. \*\*\*, të vitit 2020, të hetuar nga subjekti i rivlerësimit, dhe pretendon se ky prokuror, pa u thelluar në objektin dhe provat që i janë bashkangjitur kallëzimit, tri herë, ka marrë vendim për pushimin e procedimit dhe të tria herët vendimi është rrëzuar nga gjyqtari paraprak<sup>2</sup>. Bashkëlidhur denoncimit janë administruar vendimet e gjykatave dhe vendimet e subjektit të rivlerësimit për pushimin e çështjes penale nr. \*\*\*/2020. Nga përmbajtja e denoncimit dhe akteve bashkëlidhur duket se plotësohen kriteret e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 dhe konstatohet nevoja e hetimit të mëtejshëm në drejtim të verifikimit, nëse subjekti i rivlerësimit ka kryer hetim të gjithanshëm e të plotë, në zbatim të detyrave të lëna nga gjykata.

4. Për sqarim, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me shkresën nr. \*\*\*/\*\*\* prot., datë \*\*.12.2023, ka përcjellë kopje të denoncimeve dhe ankesave të depozituara në KPA, si vijon: (i) Denoncim nr.\*\*\* prot., datë \*\*.9.2021, i shtetasit \*\*\* \*\*\*; (ii) Denoncim nr. \*\*\* prot., datë \*\*.6.2023, i shtetases \*\*\* \*\*\*; (iii) Denoncimet nr. \*\*\*/\* prot., datë \*\*.5.2018; nr. \*\*\*/\*\* prot., datë \*\*.8.2019; nr.\*\*\* prot., datë \*\*.2.2020; nr.\*\*\*/\*\* prot., datë \*\*.7.2020; nr. \*\*\*/\*\* prot., datë \*\*.10.2019, të shtetasit \*\*\* \*\*\*. Këto denoncime, të cilat i përkasin periudhës para depozitimit të ankimit të datës 11.11.2021, janë trajtuar edhe gjatë hetimit administrativ në Komision, përveç denoncimit të shtetases \*\*\* \*\*\*, të trajtuar më sipër.

5. Pas seancës gjyqësore të datës 18.1.2024, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me shkresën nr. \*\*\*/\*\*\* prot., datë \*\*.1.2024, regjistruar në IKP me nr. \*\*/\* prot., datë \*\*.1.2024, ka përcjellë kopje të denoncimeve të shtetasit \*\*\* \*\*\*, konkretisht:

5.1 *Denoncim i regjistruar në Kolegji me nr. \*\*\*, datë \*\*.1.2024*, ku denoncuesi, shtetasi \*\*\*. \*\*\*, pretendon se subjekti i rivlerësimit, në shkelje të rëndë të ligjit, ka hetuar babain e tij në një çështje penale ku ka qenë i kallëzuar, duke bashkëlidhur një kopje të vendimit të datës \*\*.6.2015, të marrë nga subjekti i rivlerësimit mbi pushimin e çështjes penale nr. \*\*\*, të vitit 2014; si dhe një kopje të faqes së parë të vendimit nr.\*\*\*, datë \*\*.5.2004, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve pranë Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

5.1.1 Referuar këtyre akteve bashkëlidhur denoncimit rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Gjirokastrë ka regjistruar procedimin penal nr.\*\*\*, datë \*\*.9.2014, për veprën penale të “falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, mbi bazën e kallëzimit të paraqitur nga shtetasi \*\*\* \*\*\*, i cili ka pretenduar fillimin e ndjekjes penale ndaj shtetasve \*\*\* \*\*\*, \*\*\* \*\*\* dhe \*\*\* \*\*\*, për falsifikim dhe përdorim të dokumenteve të falsifikuara dhe, konkretisht, të vendimeve nr. \*\*\*, datë \*\*.11.1999, nr. \*\*\*, datë \*\*.6.2000, dhe nr. \*\*\*, datë \*\*.6.2000, të ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve, Tepelenë.

---

<sup>2</sup> Vendim, datë \*\*.3.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë; Vendim, datë \*\*.10.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin datë \*\*.4.2022; Vendim, datë \*\*.6.2023, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë.

5.1.2 Referuar akteve që janë përcjellë si pjesë e denoncimit, nga përmbajtja e vendimit nr.\*\*\*, datë \*\*.5.2004 (*1 faqe*), të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Prefektit të Qarkut Gjirokastër, rezulton se një nga anëtarët e Komisionit është shtetasi \*\*\* \*\*\*, dhe se kallëzuesi, \*\*\* \*\*\*, është një nga trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar, \*\*\* \*\*\*, pra një nga shtetasit që janë përfituesit, në cilësinë e trashëgimtarëve, të një sipërfaqe kullote prej 88 ha, referuar këtij vendimi.

5.1.3 Me vendim për pushimin e çështjes penale nr.\*\*\*, të vitit 2014, është vendosur se nuk ka elemente të figurës së veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, referuar dy akteve për të cilat ishte depozituar kallëzimi dhe regjistruar procedimi penal, konkretisht: (i) vendimi nr. \*\*\*, datë \*\*.11.1999, dhe (ii) nr. \*\*\*, datë \*\*.6.2000, të ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Tepelenë. Sa më sipër, nuk rezulton që objekt i kallëzimit, procedimit penal dhe vendimmarrjes përkatëse të ketë qenë vendimi nr.\*\*\*, datë \*\*.5.2004, i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Prefektit të Qarkut Gjirokastër. Po ashtu duket, për aq sa përmbajnë aktet e përcjella bashkëlidhur denoncimit, se ky vendim nuk është ankimuar nga palët e interesuara. Në të tilla rrethana, nuk rezultojnë të verifikohen rrethana të tilla që do të kërkonin hetim të mëtejshëm lidhur me këtë procedim.

5.2 *Denoncim i regjistruar në Kolegj me nr. \*\*/\*, datë \*\*.1.2024*, ku denoncuesi i njëjtë, shtetasi \*\*\*, \*\*\*, pretendon se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë, me vendimin e datës \*\*.10.2021, “Për shqyrtimin e kërkesës për heqje dorë të prokurorit”, nga shqyrtimi i çështjes penale nr. \*\*\*, të vitit 2021: [...] *ka vepruar duke diskriminuar e paragjykuar, me disa standarde që duken qartë në vendim, i cili jo vetëm që është veprim antiligjor, por kemi edhe shkelje të hapur të një procesi të rregullt ligjor, të lejuar me dashje nga prokurori Çafka [...]*. Denoncuesi ka bashkëlidhur fotokopje të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastër, i datës \*\*.10.2023, me objekt: “Pushimin e çështjes penale”; Kërkesë për heqje dorë të prokurorit, e datës \*\*.10.2021; Vendim i datës \*\*.10.2021, “Për shqyrtimin e kërkesës për heqje dorë të prokurorit”.

5.2.1 Referuar këtyre akteve bashkëlidhur denoncimit, rezulton se, me vendimin e tij të datës \*\*.10.2021, mbështetur në dispozitat përkatëse të K. Pr. P., subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë, nuk e ka miratuar kërkesën për heqje dorë të prokurorit \*\*\*. \*\*\*. nga hetimi i procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2021, duke arsyetuar në vendim mbi argumentet e vendimmarrjes përkatëse. Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se subjekti i rivlerësimit ka disponuar në përmbushje të diskrecionit të funksionit të drejtuesit dhe lidhur me arsyet e mospranimit të heqjes dorë, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] *Në çështjet ku ky person ushtron detyrën e avokatit, gjyqtarët e prokurorët janë bërë viktimë e shantazheve mediatike, jo për interes publik, por për interesa private të caktuara (për këtë shqetësim i jemi drejtuar me shkresë Këshillit të Lartë të Prokurorisë)[...]*. Sa trajtuar, duket se gjendemi në kushtet e pamundësisë për t’u shprehur lidhur me nevojën për hetimin e këtyre veprimeve procedurale, në mungesë të dijenisë për faktet dhe rrethanat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në shkresën drejtuar KLP-së, që përbëjnë dhe shkaqet e mospranimit të kërkesës për heqje dorë.

5.3 *Denoncim i regjistruar në Kolegj me nr. \*\*/\*\*, datë \*\*.1.2024*, ku denoncuesi, shtetasi \*\*\*, \*\*\*, ngre pretendime lidhur me shkelje flagrante dhe favorizime të subjektit të rivlerësimit në çështje që janë hetuar prej tij. Përmbajtja e këtij denoncimi ka qenë pjesë e denoncimit të datës \*\*.11.2021, nga i njëjti denoncues, i shqyrtuar nga Komisioneri Publik, dhe nuk është pjesë e ankimit të Komisionerit Publik.

5.4 *Denoncim i regjistruar në Kolegj me nr. \*\*/\*\*, datë \*\*.1.2024*, ku denoncuesi, shtetasi \*\*\*, \*\*\*, midis të tjerave, ngre pretendime lidhur me zvarritjen e një çështje penale për falsifikim të një akti noterial në Gjirokastrë, për të cilin nga gjykata nuk është pranuar kërkesa për pushim, duke e rikthyer për rihetim, pasi ka konstatuar disa shkelje dhe mangësi. Lidhur me këtë denoncim, duke mos u identifikuar procedimi konkret, aktet e lidhura apo veprimet përkatëse procedurale që eventualisht janë kryer nga subjekti i rivlerësimit, gjendemi në kushtet e pamundësisë për t'u shprehur në lidhje me nevojën për hetim të mëtejshëm.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**